



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1338/1 Prot.

Tiranë, më 28 / 09 / 2018

### V E N D I M

#### Nr. 186, Datë 28 / 09 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 92, datë 21.06.2018, të paraqitur nga V.Y kundër Shoqërisë “Byllis Energji” sh.a në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore<sup>1</sup>”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaronte se: *“Që nga viti 1988 ka qenë i punësuar pa ndërprerje në të njëjtin vend pune si teknolog në Uzinën e Naftës në Ballsh. Në datë 22.11.2017 është aksidentuar në punë dhe deri në Janar 2018 është trajtuar me raport mjekësor pasi është diagnostikuar me 6% djegie. Në muajin Mars 2018 është vënë në dijeni për përdorimin e KPTHN Ballsh<sup>2</sup> dhe kalimin e administrimit nga shoqëria “IONIAN REFINING & TRADING COMPANY” IRTC sh.a tek shoqëria “Byllis Energji” sh.a. Pas kësaj në datë 16.05.2018 i është drejtuar shoqërisë “Byllis Energji” me kërkesë për vazhdimin e marrëdhënieve të punës por nuk ka marrë përgjigje”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në pozicionin e punës.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm.

<sup>1</sup> Në datë 22.11.2017 ankuesi është aksidentuar në punë dhe deri në datë 12.01.2018 është trajtuar me raport mjekësor.

<sup>2</sup> Kombinati Përpunimit të Thellë të Naftës, Ballsh.

- Për këtë arsye, me emailin datë 22.06.2018 dhe 04.07.2018, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë për shkak të gjendjes shëndetësore, meqenëse subjekti ankues nuk ka parashtruar argumentime lidhur me këtë fakt.
- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, ankuesi me emailin datë 26.08.2018 ka dërguar kopje të kërkesë padisë kundër punëdhënësit dhe kopje të kontratës kolektive të punës datë 01.11.2016.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

<sup>3</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

1. Me shkresën me nr.939 prot., datë 02.07.2018 është njoftuar subjekti, Shoqëria “Byllis Energji” sh.a dhe i është kërkuar informacion lidhur me pretendimet e ngritura nga shtetasi V.Y.
2. Me shkresën kujtesë, nr.939/1, datë 24.08.2018 i është kërkuar përsëri informacioni i datës 02.07.2018, subjektit Shoqëria “Byllis Energji” sh.a.

Me shkresën nr.43, datë 28.08.2018, Shoqëria “Byllis Energji” sh.a, informon Komisionerin se: *“V.Y në asnjë moment nuk ka qenë i punësuar i Shoqërisë Byllis Energji dhe nuk kanë marrë ndonjë dokument, ankesë apo njoftim për raport mjekësor nga V.Y. Në lidhje me rastin ju vemë në dijeni se: - Ndërmjet shoqërisë IRTC dhe V.Y, ka patur një marrëdhënie individuale pune. Në datë 18.12.2017 marrëdhënia e punës mes ankuesit dhe IRTC ka përfunduar. Midis Byllis dhe IRTC nuk ka asnjë marrëveshje për transferim të aktivitetit dhe mes Byllis dhe ankuesit nuk ka asnjë lloj komunikimi dhe as ndonjë marrëdhënie juridike të asnjë lloji. Pikërisht për të shmangur interpretimet potenciale, midis Byllis, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Sindikatës së Përpunimit të Naftës në Shqipëri dhe Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë është nënshkruar në datë 16.04.2018, një Akt Marrëveshje, e cila parashikon qartë se: “Mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, secila palë deklaron se aktualisht nuk ka Kontratë Kolektive në fuqi, palë e së cilës është shoqëria Byllis Energji sh.a”. Mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë dhe në Direktivën 2001/23/KE “Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve”, në rast të transferimit të ndërmarrjeve ose pjesëve të ndërmarrjeve, e cila detyron Punëdhënësin që të ruajë identitetin e ndërmarrjes në kuptimin e të qenit një grup i organizuar burimesh, përfshirë këtu si burimet njerëzore, ashtu dhe ato materiale e financiare, palët e kuptojnë, pranojnë dhe deklarojnë se, nuk janë përpara rastit të transferimit të ndërmarrjes. Shoqëria Byllis Energji sh.a ka nënshkruar kontratë qiraje për të marrë me qira pasuritë në KPTHN Ballsh nga zotëruesi i tyre, dhe është në cilësinë e “Qiramarrësit”, jo të pronarit të pasurive. Byllis Energji sh.a nuk ka asnjë përgjegjësi, të asnjë lloji apo forme, në lidhje me historikun dhe/ose ngjarjet e kohës së mëparshme në KPTHN Ballsh, në veçanti, por pa kufizim, nuk ka dhe nuk merr përsipër asnjë detyrim apo përgjegjësi që lidhet me zotëruesin apo subjektet e mëparshme të cilat kanë ushtruar aktivitet në KPTHN Ballsh”.*

3. Me shkresën nr. 1188, datë 31.08.2018 i është kërkuar informacion shtesë subjektit Shoqëria “Byllis Energji” sh.a në lidhje me: - Procedurën e marrjes në punë të punonjësve pas marrjes në administrim të KPTHN Ballsh nga ana e shoqërisë Byllis Energji. - Informacion mbi numrin e punonjësve që kanë punuar në Repartin e Koksit deri në datë 18.12.2017 dhe janë rimarrë në punë nga ana e Byllis Energji. - Kopje të Akt Marrëveshjes, datë 16.04.2018 të lidhur mes Byllis, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Sindikatës së Përpunimit të Naftës dhe Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë.

Me shkresën nr. 44, datë 03.09.2018 Shoqëria “Byllis Energji” sh.a, informon Komisionerin se: *“Byllis Energji zbaton politika punësimi në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë dhe me rregulloret dhe politikat e brendshme të punësimit, referuar në veçanti fushës së aktivitetit në një sektor strategjik. BYLLIS nuk zbaton parime seleksionuese apo*

*favorizuese për asnjë person. V.Y nuk ka qenë në asnjë moment i punësuar pranë BYLLIS dhe shoqëria nuk ka detyrime ndaj tij, përfshirë detyrime punësimi. Të gjithë personat e punësuar në repartin e Koksit nuk janë rimarrë në punë nga BYLLIS në asnjë kohë apo rrethanë. BYLLIS ka të punësuar (për herë të parë në këtë shoqëri) në këtë repart një numër personash të cilët janë të nevojshëm për mbarëvajtjen e punës dhe të cilët janë konsideruar të kualifikuar dhe të pranueshëm për BYLLIS”.*

4. Me shkresën nr.1188/2, datë 07.09.2018 i është kërkuar Shoqërisë Byllis Energji kopje të Akt Marrëveshjes datë 16.04.2018 të lidhur mes Byllis, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Sindikatës së Përpunimit të Naftës dhe Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë.

Më shkresën datë 14.09.2018, protokolluar me tonën nr.1263/1, datë 17.09.2018, Shoqëria Byllis Energji dërgoi kopje të Akt Marrëveshjes datë 16.04.2018.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm të ankuesit nga Shoqëria Byllis Energji.**

Nga këqyrja e dokumentacionit<sup>4</sup> të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, V.Y deri në datë 18.12.2017 ka qenë i punësuar nga shoqëria “IONIAN REFINING & TRADING COMPANY” IRTC. Referuar Proces Verbalit mbi aksidentin në punë, rezulton se V.Y në datë 22.11.2017 është aksidentuar në punë dhe referuar Raporteve për paaftësi të përkohshme në punë nga sëmundje të përgjithshme që paguhen nga Sigurimet Shoqërore është trajtuar me raport mjekësor nga data 13.12.2017 deri më datë 28.12.2017 dhe nga data 28.12.2017 deri më datë 12.01.2018.

Në nenin 60/1/b të Kontratës Kolektive për punonjësit e IRTC (në KPTHN Ballsh) datë 01.11.2016 të hyrë në fuqi në datë 01.02.2017 të nënshkruar mes: “IONIAN REFINING & TRADING COMPANY” IRTC dhe Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë të Shqipërisë (FSPISH) dhe Sindikatës së Përpunuesve të Naftës në Shqipëri, shkruhet se: “60.1. *Kontrata Kolektive përfundon/zgjidhet apo humbet fuqinë e saj në rastet e mëposhtme: b) Punëdhënësi ka falimentuar, e vërtetuar kjo me dokumentacionin përkatës dhe fillimin e procedurave ligjore respektive”.*

Referuar, Akt Marrëveshjes, datë 16.04.2018 të lidhur midis: Shoqërisë “BYLLIS Energji” SHA, nën kujdesin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë dhe Sindikatës së Përpunimit të Naftës në Shqipëri, në mes të tjerash shkruhet se: “Mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, secila palë deklaroi se

---

<sup>4</sup> Referuar Librezës së punës së V.Y, nr.3049 të lëshuar nga Uzina e Naftës Ballsh.

*aktualisht nuk ka Kontratë Kolektive në fuqi, palë e së cilës të jetë shoqëria Byllis Energji sh.a. .... Shoqëria BYLLIS Energji sh.a ka nënshkruar kontratë qiraje me pronarin e ligjshëm për të marrë me qira pasuritë në KPTHN Ballsh nga zotëruesi i tyre, dhe është në cilësinë e “Qiramarrësit”, jo të pronarit të pasurive”.*

Lidhur me sa më sipër konstatohet se marrëdhëniet e punësimit mes ankuesit, V.Y me punëdhënësin IRTC kanë përfunduar në datë 18.12.2017. Referuar Akt Marrëveshjes, datë 16.04.2018 të lidhur midis: Shoqërisë “BYLLIS Energji” SHA, nën kujdesin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë dhe Sindikatës së Përpunimit të Naftës në Shqipëri, vlerësohet se, nga data 18.12.2017, datë kur është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të punës të V.Y me punëdhënësin IRTC deri më datë 16.04.2018 kur është lidhur Akt Marrëveshja me BYLLIS Energji, ankuesi V.Y dhe të gjithë punonjësit e tjerë të Shoqërisë IRTC nuk kanë patur marrëdhënie kontraktuale punësimi dhe referuar informacioneve të publikuara në media<sup>5</sup> me punëdhënësin e ri (Byllis Energji) janë punësuar rreth 150 punonjës ndërsa rreth 1000 punonjës të tjerë nuk janë thirrur ende në detyrë.

Referuar Akt Marrëveshjes dhe termave të Kontratës Kolektive të punës, nga ana e Shoqërisë “BYLLIS Energji” nuk ka patur ndonjë detyrim ligjor për vazhdimin e marrëdhënieve të punësimit me ankuesin V.Y.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një lidhje shkakësore mes trajtimit të pabarabartë dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, pasi Shoqëria Byllis Energji nuk ishte në dijeni të historikut të gjendjes shëndetësore të ankuesit V.Y. Subjekti ankues nuk vuri në dispozicion të Komisionerit ndonjë dokument në të cilin të faktohej gjendja e tij shëndetësore pas datës 12.01.2018 dhe që do të ndikonte tek punëdhënësi Byllis Energji për të mos lidhur marrëdhënie punësimi me V.Y pas datës 16.04.2018.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, dhe shpjegimet e dhëna nga Shoqëria “Byllis Energji” SHA, lidhur me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, vlerësohet se nuk rezulton i provuar fakti që V.Y të jetë trajtuar në mënyrë të pafavorshme nga ana e Shoqërisë Byllis Energji, dhe se vendimmarrja për mosmarrjen e tij në punë, të jetë paragjykuar, ndikuar, direkt apo indirekt, për shkak të gjendjes shëndetësore të V.Y.

**Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet e Shoqërisë “BYLLIS Energji” nuk kanë qenë diskriminuese në drejtim të mosvendosjes së marrëdhënieve të punësimit me V.Y, por Komisioneri duke vlerësuar eksperiencën, përkushtimin dhe historikun e marrëdhënieve të punësimit mes V.Y dhe KPTHN Ballsh i rekomandon Shoqërisë “Byllis Energji” që në të ardhmen të konsiderojë lidhjen e marrëdhënieve të punësimit me V.Y.**

<sup>5</sup> <https://www.rtsh.al/lajme/tension-ne-kpthn-ballsh-punetoret-kerkojne-nisjen-e-punes/>

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit V.Y nga ana e Shoqërisë “BYLLIS Energji”, për shkak të gjendjes shëndetësore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(shkaku: gjendja shendetesore)

(fusha: punesim)